



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/60
Datë: 08.02.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 12 paragrafit 2. të Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 shkurt 2012, mori:

V E N D I M

1. Autorizohet Ministri i Financave që të aprovoj transferet nga programi-Shpenzimet e paparashikuara për shumatat individuale të kërkuara deri në vlerë prej 20,000 (njëzet mijë) euro për vitin 2012.
2. Shuma e totalit të këtij autorizimi nuk mund të kalojë 20% (njëzet përqind) të shumës së ndarë vjetore të programit - Shpenzimet e paparashikuara.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe zbatohet deri më 31.12.2012.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/60

Datë: 08.02.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 03/L-079 për ndryshimin e rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 shkurt 2012, mori:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës për anëtar në Bordin e Agjencisë Kosovare të Pronës i propozon Kuvendit të Republikës së Kosovës:
 - 1.1. Z. Ujup Krasniqi dhe
 - 1.2. Z. Ismajl Osdautaj.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që vendimin së bashku me biografinë e të propozuarve nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedoj për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/60
Datë: 08.02.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 shkurt 2012, mori:

V E N D I M

1. Miratohet Rregullorja për organizimin e brendshëm të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe sistematizimin e vendeve të punës.
2. Obligohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/60
Datë: 08.02.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 shkurt 2012, mori:

V E N D I M

1. Pika e aftësisë së filtrimit të naftës i cili përdoret për motorët me djegie të brendshme e që ndezja bëhet me komprimim të jetë $-25\text{ }^{\circ}\text{C}$ deri në përmirësimin e kushteve klimatike.
2. Obligohen të gjitha Kompanitë Importuese të naftës për zbatimin e pikës 1. të këtij vendimi.
3. Obligohet Trupa Inspektuese e autorizuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë që të monitoroj zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë
- Doganës së Kosovës



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/60
Datë: 08.02.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe të Rregullores nr. 06/2010 për procedurat e emërimit në pozita të larta drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 shkurt 2012, mori:

V E N D I M

1. Z. Blerim Camaj, emërohet Kryeshef Ekzekutiv në Agjencinë e Regjistrimit Civil.
2. Mandati i të emëruarit nga pika 1. e këtij vendimi zgjat tre (3) vjet.
3. I emëruari nga pika 1. e këtij vendimi kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
4. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/60
Datë: 08.02.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe të Rregullores nr. 06/2010 për procedurat e emërimit në pozita të larta drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 shkurt 2012, mori:

V E N D I M

1. Z. Sami Dvorani, emërohet Kryeshëf Ekzekutiv në Institutin Gjeologjik të Kosovës.
2. Mandati i të emëruarit nga pika 1. e këtij vendimi zgjat tre (3) vjet.
3. I emëruari nga pika 1. e këtij vendimi kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
4. Obligohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/60

Datë: 08.02.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 shkurt 2012, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet shuma buxhetore në vlerë prej 1,000,000 (një milion) euro për realizimin e marrëveshjes në mes të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe Agjencisë së lajmeve CNN. Kjo marrëveshje ka për qëllim promovimin e potencialeve të vendit tonë para investitorëve të huaj.
2. Obligohet Ministria e Tregtisë dhe Industrisë që pas aprovimit të këtij vendimi nga Qeveria e Kosovës të ndërmarr të gjitha veprimet me qëllim të realizimit të kësaj marrëveshjeje, në pajtim me këtë vendim.
3. Mjetet që nevojiten për financimin e këtij projekti që janë të nevojshme deri në rishikimin e buxhetit sigurohen nga Rezerva e Qeverisë, ndërsa pjesa tjetër e mbetur do të jetë pjesë e buxhetit të rregullt të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/60
Datë: 08.02.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 shkurt 2012, mori:

V E N D I M

1. Komiteti Drejtues Ndërministror i themeluar në pajtim me Vendimin e Qeverisë Nr. 02/41 të datës 10 tetor 2011 do të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për t'u përgatitur, në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, si dhe Ligjit Nr. 03/L-205 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, për shpronësimin e çdo pasurie të paluajtshme, pavarësisht nëse është në pronësi private, në pronësi shoqërore ose pronësi të komunës, duke përfshirë pasurinë e paluajtshme të ndërmarrjes shoqërore "INEX SHARR PLANINA-Brezovicë", që mund të kërkohet për implementimin e projektit për zhvillimin e "Brezovicës". Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, duke vepruar për dhe në emër të Komitetit Drejtues Ndërministror, do t'i dorëzojë Qeverisë, sipas rastit, çdo kërkesë të nevojshme për punët përgatitore dhe për iniciimin e procedurave të shpronësimit në përputhje me ligjin në fuqi.
2. Komuna e Shtërpcës do të marrë gjitha masat e nevojshme, në përputhje me ligjin në fuqi, për të parandaluar ndonjë ndërtim ilegal, dhe të largoj çdo ndërtim ekzistues të paligjshëm, në zonat që do të përcaktohen nga Komiteti Drejtues Ndërministror për implementimin e Projektit për zhvillimin e "Brezovicës".
3. Çdo Shpronësim i pasurisë së paluajtshme, që mund të jetë i nevojshëm për zbatimin e projektit, do të zhvillohet në përputhje të plotë me Ligjin për Shpronësimin e pronës së paluajtshme, duke siguruar kompensim në vlerë tregu për çdo pronë të paluajtshme të shpronësuar.

4. Mjetet që do të kërkohen për pagesën e kompensimit të pronave që do të jenë objekt i shpronësimit do të sigurohen përmes procesit të rregullt buxhetor.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretariat të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/60
Datë: 08.02.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 19 të Ligjit nr. 03/L-95 për të Drejtat e ish të Dënuarve dhe të Përndjekurve Politik, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 shkurt 2012, mori:

V E N D I M

Për themelimin e Komisionit Qeveritar për njohjen e statusit të ish të dënuarve dhe të ish të përndjekurve politikë (Komisioni)

1. Komisioni përbëhet nga këta përfaqësues:
 - 1.1. Rrahim Rama - Ministria e Drejtësisë;
 - 1.2. Basri Ibrahim - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;
 - 1.3. Qeram Telqiu - Ministria e Shëndetësisë;
 - 1.4. Një (1) deputet i Kuvendit të Kosovës nga komisioni përkatës;
 - 1.5. Hydajet Hyseni - Shoqata e të Burgosurve Politikë të Kosovës, dhe
 - 1.6. Mazllum Baraliu - Shoqata e Juristëve të Kosovës.
1. Komisioni i përcakton kushtet, kriteret, llojin dhe mënyrën e zhdëmtimit (kompensimit) të personave në përputhje me nenin 3 të Ligjit nr. 03/L-95 për të Drejtat e ish të Dënuarve dhe të Përndjekurve Politik, me procedurë të caktuar me këtë ligj dhe me akte të tjera gjegjëse nënligjore të miratuara nga Qeveria.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi Shfuqizohet Vendimi i Qeverisë Nr. 07/49, i datës 23.11.2011.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/60
Datë: 08.02.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. Dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 të Ligjit nr. 03/1-185 për Rregullatorin e Energjisë, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 shkurt 2012, mori:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës për anëtar në Bordin e Zyrës së Rregullatorit për Energji, propozon:
 - 1.1. Krenar Bujupi dhe
 - 1.2. Ahmet Latifi
2. Për kryesues të Bordit propozohet anëtari aktual z. Enver Halimi.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që vendimin së bashku me biografinë e të propozuarve nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedoj për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
4. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë